



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

05 NR. 426

Datë : 19.08.2024

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversital në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, :Ligjin për Arsim dhe aftësim profesional nr.04L-138 dheUdhezimin administrativ Nr.22/2013, numri maksimal i nxënësve në klasa dhe raporti mësimdhënës-nxënës si dhe bazuar në Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Gjimnaze dhe Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP), të caktuara nga MASHT, Drejtoria komunale e Arsimit-Suharekë shpall

KONKURS PLOTËSUES
PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2024/2025

1.Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe IAAP në vitin shkollor 2024/25, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9 të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2.Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe IAAP, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Ekstraktin e lindjes.

3.Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe IAAP, për vitin shkollor 2024/2025, bëhet më datën 19, 20 dhe 21 gusht 2024, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 22.08.2024.

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda (2) dy ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve. Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkallën e dytë bëhen në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda (2) dy ditë pune, pas pranimi të përgjigjes nga shkolla

A.Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- | | |
|---|---------------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar | (20%) 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

Komuna	Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr.i paral.	Nr.i nx.
	IAAP "Skender Luarasi"	Makineri, prodhim dhe ndertimtari	Instalues elektrik	1	4
			Automekanik	1	2
			Mekatronikë	1	6
		Art	Rrobaqepësi	1	16
			Dizajn i enterierit	1	6
			Dizajn i tekstilit dhe veshjeve	1	6
Suharekë/ Shirokë	IAAP "Abdyl Ramaj"	Ekonomi, Administrim dhe Juridik	Kontabiliteti	1	8
			Banka dhe sigurime	1	10
			Tregti me pakicë dhe shumicë (Mësim Dual)	1	12
		Shërbime (Hoteleri - Turizem)	Asistent i mikpritjes hoteliere (Mësim Dual)	1	10
		Teknologji prodhimi dhe ndertimtari	Laborant i kimisë	1	2
		Agrokulturë, Veterinari, Teknologji ushqimore	Pemëtar - Vreshtar	1	16
Teknologjia ushqimore	1		12		
Suharekë	"Jeta e re"	Gjimnaz	Shkenca natyrore	2	39
		Gjimnaz	Shkenca shoqërore dhe gjuhësore	3	69

Drejtori i DKA-së-Suharekë

Remzi Bajselmani

